
POSTIM ARKIVOR

Vendime të Komisionit të Internim Dëbimeve dhe Konfiskimeve



për në Jugosllavi.

V 8)Të internohet në Lushjë Hu[redacted],i biri H[redacted]i dat-lindjes 1913,lindur në qytetin e Gjirokastrës,për arsye se paraqet rrezikshmëni shoqërore.

Internimi ju fillon më 19/3/1965 dhe ju mbaron më datën 19/3/1970 për 5 vjet kohë.

KRYETAR'I KOMISJONIT T'INTERNIM-DËBIMEVE
GJENERAL-KOLONEL
(Beqir Balluku)

ZV.KRYETAR KOMISJONI A N T A R A N T A R A N T A R
GJENERAL-LEITNANT MINISTËR DREJ. PROKUROR PËRGJ.KRYETAR GJYK.L
(Kadri Hazbiu) (Bilbil Klosi) (Aranit Çela)(Shuaip Spahiu)

SEKSIONI

Vendime Internimi / Dëbimi

PERIUDHA

1954 - 1990

Internimi dhe dëbimi ishin masa administrative të përdorura gjatë regjimit komunist ndaj individëve dhe familjeve të konsideruara nga autoritetet si politikisht të padëshiruara. Internimi nënkuptonte vendosjen e detyruar në një zonë të përcaktuar, me kufizim të lëvizjes dhe mbikëqyrje administrative, ndërsa dëbimi nënkuptonte largimin e detyruar nga vendbanimi. Masat prekën kategori të ndryshme personash, përfshirë familjarë të të arratisurve, persona të dënuar ose të konsideruar kundërshtarë politikë dhe familje të ish-funksionarëve. Sipas statistikave të Ministrisë së Punëve të Brendshme, gjatë viteve 1945–1990 u internuan 48.217 burra dhe 10.792 gra , ndërsa 11.536 familje u dëbuan nga qytetet kryesore dhe zonat kufitare.

PERMBAJTJE #1


Internimet dhe dëbimet në Shqipëri gjatë regjimit komunist (1945–1990)

Internimi dhe dëbimi ishin masa administrative të përdorura nga autoritetet shtetërore gjatë regjimit komunist në Shqipëri, veçanërisht ndaj personave dhe familjeve të konsideruara politikisht të padëshiruara ose me rrezikshmëri për regjimin. Këto masa u zbatuan gjatë gjithë periudhës së regjimit, nga paslufta deri në vitet e fundit të tij. Internimi nënkuptonte vendosjen e detyruar të një personi ose familjeje në një zonë të përcaktuar nga autoritetet, me kufizim të lirisë së lëvizjes dhe nën mbikëqyrje administrative. Dëbimi nënkuptonte largimin e detyruar nga vendbanimi dhe transferimin në një vend tjetër të përcaktuar nga shteti. Në shumë raste, masat prekën familje të tëra dhe përfshinë edhe gra e fëmijë. Kategoritë e personave të internuar ose dëbuar ndryshonin në periudha të ndryshme. Në dokumentet administrative dhe të organeve të Sigurimit të Shtetit shfaqen, ndër të tjera, familjarë të personave të arratisur jashtë vendit, persona të dënuar ose të konsideruar kundërshtarë politikë, familje të ish-funksionarëve, si dhe persona të klasifikuar nga autoritetet me terminologji të kohës si “elementë antiparti”, “kulakë”, “reaksionarë” apo “me tendencë arratisjeje”. Sipas të dhënave, në statistikat e Ministrisë së Punëve të Brendshme, gjatë viteve 1945–1990 u internuan 48.217 burra dhe 10.792 gra, ndërsa nga qytetet kryesore dhe zonat kufitare u dëbuan 11.536 familje. Dokumentacioni arkivor pasqyron mënyrën se si funksiononte sistemi i internimit dhe dëbimit: nga propozimi dhe vendimmarrja administrative, te regjistrimi i personave, transferimi, vendosja në kamp ose zonën e caktuar, kontrolli i lëvizjeve dhe raportimi periodik. Në këtë dokumentacion përfshihen vendime internimi dhe dëbimi, kartela individuale dhe familjare, lista dhe regjistra, korrespondencë administrative, raporte të organeve të Sigurimit të Shtetit, dokumente mbi lëvizjen e familjeve dhe materiale të tjera që lidhen me jetën e të internuarve. Këto dokumente mundësojnë studimin e fenomenit jo vetëm përmes të dhënave statistikore, por edhe përmes historive konkrete të individëve dhe familjeve të prekura nga këto masa. Mediateka e AIDSSH synon ta bëjë këtë dokumentacion të aksesueshëm dhe të organizuar në mënyrë tematike, duke krijuar mundësi për kërkim, studim dhe njohje të historisë së internimeve dhe dëbimeve gjatë regjimit komunist në Shqipëri.

MEDIA #1

Konfiskimi i pasurisë së një familjeje të arratisur në Jugosllavi – Vendimi nr. 39, 23 janar 1954

MEDIA FAQE #1



REPUBLIKA POPULLORE E SHQIPERISE
MINISTRIJA E PUNEVE TE BRENDSHME
KOMISIONI DEBIMEVE E KONFISKIMEVE
Nr. 8 Vendimit.

Teper Sekret.
Tiranese date 30-1- 1954.

V E N D I M.

Komisioni debimeve dhe konfiskimeve prane Ministrise se Puneve te Brendeshme, i perbere prej:

1.Gjeneral-Leitnant	Mehmet Shehu	Kryetar
2.Gjeneral-Major	Mihallaq Ziçishti	Anetar
3.N/Kolonel	Nevzat Nazmedari	Anetar
4.N/Kolonel	Rexhep Kolli	Anetar
5.N/Kolonel	Jashar Kasimati	Anetar
6.Major	Sabri Sevreni	Anetar

Ne seancen e dates 8 Janarit 1954, mbasi mori ne shqyrtim propozimin e Degas Puneve te Brendeshme te Krahit Tropojes per konfiskimin e krejt pasuris te arratisurit familjarisht ne Jugosllavi Rexh Mehmetit i biri Mehmetit nga katundi Çerem i Tropojes, bujke, fshetar i mesem, i arratisur ne vitin 1953;

K O N S T A T O I -S E:

Duke qene se R[redacted] ndodhet i arratisur ne Jugosllavi me gjith familje i perbere prej 10 personash qe ne vitin 1953, ketu nuk ka lene asnjeri dhe pasurija ndodhet e bllokuar, ne mbeshtetje te ligjit Nr. 649 date 10 Janar 1949 mbi sbatimin e debimit dhe te konfiskimit;

V E N D O S I:

Konfikimin e krejt pasuris te arratisurit familjarisht ne Jugosllavi R[redacted], nga katundi Çerem i Tropojes.

Ky vendim hyne ne fuqi me nji here.

KRYETAR'I KOMISIONIT
GJENERAL-LEITNANT
(MAHMET SHEHU)

ANETAR MAJOR (SABRI SEVRANI) ANETAR N/KOLONEL (JASHAR KASIMATI) ANETAR N/KOLONEL (REXHEP KOLLI) ANETAR N/KOLONEL (N.NAZMEDARI) ANETAR GJENERAL-MAJOR (MIHALLAQ ZIQISHT)

Konfiskimi i pasurisë së një familjeje të arratisur në Jugosllavi – Vendimi nr. 39, 23 janar 1954

INFORMACION

Konfiskimi i pasurisë së një familjeje të arratisur në Jugosllavi – Vendimi nr. 39, 23 janar 1954

FONDI	49
DOSJA	15
VITI	1954
NUMRI I FAQEVE	50
LLOJI I DOKUMENTIT	Vendim
DATA E KRIJIMIT	30.01.1954
KOMISIONI	Mehmet Shehu

ANËTARËT	Mihallaq Ziçishti, Nevzat Haznedari,Rexhep Kolli, Jashar Kasimati, Sabri Sevrani


TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

MEDIA #2

Vendimi nr. 37, 30 tetor 1954 Internimi për pesë vjet i një ish-punonjësi të administratës

MEDIA FAQE #1



REPUBLIKA POPULLORE E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME
KOMISIONI DEBIMEVE E KONFISKIMEVE
Nr. 37 Vendimit.

TEPER SEKRET.
Tiranë 30.X. 1954.

V E N D I M:

Komisioni debimeve dhe konfiskimeve prane Ministrise se Punëve te Brendeshme,i perbere prej:

1.Gjeneral-Leitnant	Mehmet Shehu	Kryetar
2.Gjeneral-Major	Kadri Hazbiu	Zv.Kryetar
3.Gjeneral-Major	Dalo Balili	Anetar
4.N/Kolonel	Nevzat Hasnedari	Anetar
5.N/Kolonel	Rexhep Kolli	Anetar
6.N/Kolonel	Jasher Kasimati	Anetar

Ne seancen e dates 15 Mars 1954,mbasi mori ne shqyrtim propozimin e Ministrise se Punëve te Brendeshme per internimin e D[redacted],i biri i [redacted] dhe i S[redacted] i dat-lindjes 1910,lindur dhe banues ne Gjinokaster,me kombesi dhe nenshtetesi shqiptare,rrjedh nga nji shtres qytetare mesem,me arsim te mesem i martuare;

K O N S T A T O J - S E:

I nalt-permenduri gjat rregjimit mogut ka sherbyer si daktilografist ne Prefekturat e stershme deri ne vitin 1936,prej kesaj kohe e deri ne vitin 1939 esht marre si arshivist i zyres sekrete ne Ministrin e P.Brendeshme,po kete detyre ka pasur dhe ne kohen e okupacionit Italjan si sekretar i Lire i kesaj zyre,ky ka pasur dhe detyren e fondit sekret qe fshtohet nga deponimet e kapura,ne vitin 1946 esht denuare me tre vjet burge pse esht kapur duke marre pjese me nji grup bandash,qenje e tij e lire persqet rrezikshmeni,ne mbeshtetje te nenit 1 te ligjes Nr.649 date 10 Janar 1949 mbi shetimin e debimeve e konfiskimeve;

V E N D O S I:


Internimin e D[redacted] nga Gjinokastra per ne [redacted] per 5 vjet kohe,duke i fillusre me 30 Mars 1954 dhe duke i mbarusre me 30 Mars 1959.

Ky vendim hyne me nji here ne fuqi.-

KRYETARI I KOMISJONIT
GJENERAL-LEITNANT
(MEHMET SHEHU)

Vendimi nr. 37, 30 tetor 1954 Internimi për pesë vjet i një ish-punonjësi të administratës

MEDIA FAQE #2



Vendimi nr. 37, 30 tetor 1954 Internimi për pesë vjet i një ish-punonjësi të administratës

INFORMACION

Vendimi nr. 37, 30 tetor 1954 Internimi për pesë vjet i një ish-punonjësi të administratës

FONDI	49
DOSJA	15
VITI	1954
NUMRI I FAQEVE	50
LLOJI I DOKUMENTIT	Vendim
NR.	37
DATË	30.10.1954
KOMISIONI	Mehmet Shehu
ANËTARËT	Kadri Hazbiu, Delo Balili, Nevzat Haznedari, Rexhep Kolli, Jashar Menzelxhiu


TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

MEDIA #3

Vendim nr. 2, datë 25.01.1965 i Komisionit Internim-Dëbime

MEDIA FAQE #1



REPUBLIKA POPULLORE E SHQIPËRISË
"KOMISIONI INTERNIM-DËBIMEVE"

"TEFER SEKRET"

Tiranë, më 25/1/1965

V E N D I M Nr. 2

Komisioni i internim-dëbimeve, i mbledhur më datën 25/1/1965, i kryesuar nga kryetar i Komisionit Gjeneral-Kolonel Beqir Balluku dhe i përbërë nga Zv.kryetar i Komisionit Gjeneral-Leitnant Kadri Hazbiu, me antarë Komisioni ministrin e drejtësisë shokun Bilbil Klosi, Prokurorin e Përgjithshëm shokun Aranit Çela, Kryetarin e Gjykatës së Lartë shokun Shuaip Panariti, të ndihmuar nga dekreti i Presidiumit Kuvendit Popullor Nr.1027 datë 12 Janar 1960, mbasi studjuan materjalet dhe propozimin e paraqitur nga Ministrija e Punve të Brendshme ;

V E N D O S I

1)T'internohet në [redacted] i biri T[redacted] dhe i [redacted] datëlindjes 1923, lindur dhe banues në katundin Alarup të Krrethit Pogradecit, me profesion bujk, i martuar dhe ka 4 fëmijë, me arsim 4 klas fillore, i dënuar një herë për gjakmarrje ordinere me 2 muaj, i përjashtuar nga partija, shtresë e pasur (kulak)

Në vjetin 1950-1951 i janë arrestuar në Jugosllavi dy kushurinjt e tij [redacted] e N[redacted] të cilët janë vënë në shërbim të zbulimeve të huaja dhe përdoreshin diversantë kundra vëndit tonë. Kohët e fundit i përmënduri ka çfaqur tendencën e arratisjes për në Jugosllavi familjarisht.

Internimi i fillon më 25/1/1965 dhe i mbaron më 25/1/1970 për 5 vjet kohë.

KRYETAR'I KOMISJONIT T'INTERNIM-DËBIMEVE
GJENERAL-KOLONEL
(Beqir Balluku)

ZV.KRYETAR KOMISIONI ANËTARË ANËTARË
GJENERAL-LEITNANT MINISTËR DREJT. PROKUROR I PËRGJITHSHËM KRYETARË
(Kadri Hazbiu) (Bilbil Klosi) (Aranit Çela) (Shuaip Panariti)

Vendim nr. 2, datë 25.01.1965 i Komisionit Internim-Dëbime

INFORMACION

Vendim nr. 2, datë 25.01.1965 i Komisionit Internim-Dëbime

FONDI	49
DOSJA	84
VITI	1965
NR. I FLETEVE	68
LLOJI I DOKUMENTIT	Vendim
NR.	2
DATA E KRIJIMIT	25.01.1965
KOMISIONI	Beqir BAlluku

ANËTARËT	Kadri Hazbiu, Bilbil Klosi, Aranit Cela, Shuaip Panariti


TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

MEDIA #4

Vendimi nr. 4, datë 19 mars 1965 – Lirimi nga internimi dhe dëbimi me ndalim banimi e qarkullimi

MEDIA FAQE #1



REPUBLIKA POPULLORE E SHQIPËRISË "TEPËR SEKRET"
"KOMISIONI INTERNIM-DËBIMEVE"
---------- Tiranë, më 19/3/1965

V E N D I M Nr. 4

Komisjoni i Internim-dëbimeve, i mbledhur më datën 19/3/1965, i kryesuar nga Kryetar i Komisjonit Gjeneral-Kolonel Beqir Balluku dhe i përbërë nga Zv.Kryetar i Komisjonit Gjeneral-Lejtnant Kadri Hazbiu, me antarë Komisjoni Ministrin e Drejtësisë shokun Bilbil Klosi, Prokurorin e Përgjithshëm shokun Aranit Çela, Kryetarin e Gjykatës së Lartë shokun Shuaip Fanariti, të ndihmuar nga dekreti i Presidiumit Kuvendit Popullor Nr.3027 datë 12 Janar 1960, mbasi studjuan materjalet dhe propozimet e paraqitura nga Ministrija e Punve të Brendëshme :

V E N D O S I

Që personat e poshtë shënuar, të lirohen nga internimi dhe të dëbohen, duke ju ndaluar banimin dhe qarkullimin në vëndet që shënohen bri sejcilit;

√1) Dh[redacted], e dat-lindjes 1938.

√2) [redacted], i dat-lindjes 1940

√3) M[redacted] e dat-lindjes 1908, të tre të përmëndurve ju ndalohet banimi dhe qarkullimi në rrethet:Korçë, Pogradec, Kolonjë, Përmet, Gjirokastër, Sarandë, Librazhd, Shkodër, Kukës, Tropojë, Peshkopi, si dhe qytëti i Tiranës, Durrësit, Qyteti Stalin dhe Patosi.


√4) L[redacted] i biri Mezanit dhe i Melos, i dat-lindjes 1937, lindur dhe banuës në katundin Markat të rrethit Sarandës, shtres e pasur këtij i ndalohet banimi dhe qarkullimi në lokalitetet Hoxhe dhe Koni spol e Theollogo të rrethit Sarandës.

5) M[redacted], i biri Dhimitrit dhe i Evjenos, i dat-lindjes 1930, lindur dhe banuës në katundin Sopik të rrethit Gjirokastrës dhe i internuar në fshatin e Borshit të rrethit Sarandës, dëbohet dhe i ndaluar banimin dhe qarkullimin 5 kilometra larg kufirit kudo për-

///

Vendimi nr. 4, datë 19 mars 1965 – Lirimi nga internimi dhe dëbimi me ndalim banimi e qarkullimi

MEDIA FAQE #2



- 2 -

fshirë edhe katundin Sopik dhe të vendoset brënda rrethit Gjirokastrës.

Dëbimi ju fillon më 19/3/1965 dhe ju mbaron më datën 19/3/1970 për 5 vjet kpmë.

KRYETAR'I KOMISJONIT TË INTERNIM-DËBIMEVE
GJENERAL-KOLONEL
(Beqir Balluku)

ZV.KRYETAR'I KOMISJONIT A N T A R A N T A R A N T A R
GJENERAL-LEITNANT MINISTËR DREJT. PROKUROR PËRGJ.KRYET.GJYK.LARTË
(Kadri Hasbiu) (Bilbil Klosi) (Aranit Çela) (Shuaip Panariti)

Vendimi nr. 4, datë 19 mars 1965 – Lirimi nga internimi dhe dëbimi me ndalim banimi e qarkullimi

INFORMACION

Vendimi nr. 4, datë 19 mars 1965 – Lirimi nga internimi dhe dëbimi me ndalim banimi e qarkullimi

FONDI	49
DOSJA	84
VITI	1965
NUMRI I FAQEVE	68
LLOJI I DOKUMENTIT	Vendim
NR.	4
DATË	19.03.1965
KOMISIONI	Beqir Balluku
ANËTARËT	Beqir Balluku Kadri Hasbiu Bilbil Klosi Aranit Çela Shuaip Panariti


TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

MEDIA #5

Vendimi nr. 5, datë 19.04.1969 – Për lirimin nga internimi

MEDIA FAQE #1



REPUBLIKA POPULLORE E SHQIPËRISË
"KOMISJONI INTERNIM-ËRBIMEVE"

"TEPËR SEKRET"

Tiranë, më 19-IV- 1965

V E N D I M Nr. 5

Komisjoni i Internim-dëbimeve, i mbledhur më datën 19-IV- 1965, i kryesuar nga Kryetar i Komisjonit Gjeneral- Kolonel Beqir Balluku dhe i përbërë nga Zv/Kryetar i Komisjonit Gjeneral-Leitnant Kadri Hazbiu, me anëtarë Komisjoni Ministrin e Drejtësisë shokun Bilbil Klosi, Prokurorin e Përgjithshëm shokun Aranit Çela, Kryetarin e Gjykatës së Lartë shokun Shuaip Pamariti, të udhëhequr nga dekreti i Presidiumit Kuvendit Popullor Nr.3027 datë 12 Janar 1960, mbasi studjuan materjalet dhe propozimet e paraqitura nga M.P.Brendëshme:

V E N D O S I


1)Të lirohet nga internimi [redacted] i biri i [redacted] dhe i [redacted] i dat-lindjes 1900, lindur në katundin Leshnicë dhe banuës në katundin Cërkovicë të lokalitetit Theollogos të rrethit Sarandës, me arsim 4 klas fillore Greke, shtresë e pasur, me kombësi minoritare Greke dhe shtetësi Shqipëtare, i martuar, i pa dënuar ndonjë herë. I internuar në fermën e Borshit me vendim Nr.4 datë 24/I/1964, për arsye se në muajin Prill 1963 ju arratisën në Greqi dy djem e tij P[redacted] e Te[redacted] nga ristudimi dolli se me dy djemt e arratisur ka qënë i ndarë para 20 vjetëve dhe se i ka pasur me grua e parë.

2)Të lirohet nga internimi [redacted], e dat-lindjes 1912, lindur dhe banuse në katundin Karë të rrethit Sarandës dhe e internuar në fermën e Borshit me vendim Nr.62 datë 9/X/1961, për arsye se ka t'arratisur burrin e saj V[redacted] i cili është vënë në shërbim të zbulimeve të huaja. Lirimi i saj nuk paraqet ndonjë rrezikshmëni, mbasi është e sëmurë.

3)Të lirohet nga internimi V[redacted], i biri [redacted] dhe i K[redacted] i dat-lindjes 1898, lindur dhe banuës në katundin Qemurjo të rrethit Sarandës, i internuar në fermën e Borshit me vendim Nr.21 datë 23/3/1962, për arsye se në këtë kohë i arratiset në Greqi djali i tij Nasho Thanasi.

///

MEDIA FAQE #2



- 2 -

4)Të lirohet nga internimi [redacted] e dat-lindjes 1911, gruaja e V[redacted]

Të dy këta persona propozohen për lirim, mbasi janë të kolur nga mosha dhe se nuk paraqesin ndonjë rrezikshmëni. Nga kjo familje mbeten n'internim [redacted] Ballaj i t'arratisurit N[redacted] dhe R[redacted] gruaja e t'arratisurit.

KRYETAR'I KOMISIONIT T'INTERNIM-DËBIMEVE
GJENERAL-KOLONEL
(Beqir Balluku)

ZV.KRYETAR KOMISIONI GJENERAL-LEITNANT (Kadri Hazbiu)

A N T A R

MINISTËR DREJT. (Bilbil Klosi)

A N T A R

PROKUROR PËRGJ. (Aranit Çela)

A N T A R

KRYETAR GJYK.LARË (Shuaip Pamariti)

ARSH

INFORMACION

Vendimi nr. 5, datë 19.04.1969 – Për lirimin nga internimi

FONDI	49
DOSJA	84
VITI	1965
NR. I FLETEVE	68
LLOJI I DOKUMENTIT	Vendim
NR.	5
DATË	19.04.1969
KOMISIONI	Beqir Balluku
ANËTARËT	Kadri Hazbiu, Bilbil Klosi, Aranit Çela, Shuaip Panariti


TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

MEDIA #6

Vendimi nr. 6, datë 25 mars 1965, i Komisionit të Intern-im-Dëbimeve

MEDIA FAQE #1



REPUBLIKA POPULLORE E SHQIPËRISË
"KOMISIONI INTERNIM-DËBIMEVE"

"TEPËR SEKRET"

Tiranë, më 25/3/1965

V E N D I M Nr. 6

Komisioni i Internim-dëbimeve, i mbledhur më datën 25/3/1965, i kryesuar nga Kryetar i Komisionit Gjeneral-Kolonel Beqir Balluku dhe i përbërë nga Zv.kryetar i Komisionit Gjeneral-Leitnant Kadri Hazbiu, me anëtarë Komisioni Ministrin e Drejtësisë shokun Bilbil Klosi, Prokurorin e Përgjithshëm shokun Aranit Çela, Kryetarin e Gjykatës së Lartë shokun Shuaip Panariti, të udhëhequr nga dekreti i Presidiumit Kuvendit Popullor Nr.3027 datë 12 Janar 1960, mbasi studjuan materjalet dhe propozimin e paraqitur nga Ministrija e Punve të Brëndshme;

V E N D O S I

Të lirojë nga internimi K[redacted] i dat-lindjes 1925, lindur në Berat, banues në qytetin e Tiranës dhe së ati i internuar në Shijak të rrethit Durrësit.

KRYETAR I KOMISIONIT T'INTERNIM-DËBIMEVE
GJENERAL-KOLONEL
(Beqir Balluku)

ZV.KRYETAR KOMISIONI — ANTAR — ANTAR — ANTAR
GJENERAL-LEITNANT — MINISTËR DREJT. — PROKUROR PËRGJ.KRYETT.GJYK.L.RTË
(Kadri Hazbiu) (Bilbil Klosi) (Aranit Çela) (Shuaip Panariti)

Vendimi nr. 6, datë 25 mars 1965, i Komisionit të Internim-Dëbimeve

INFORMACION

Vendimi nr. 6, datë 25 mars 1965, i Komisionit të Internim-Dëbimeve

FONDI	49
DOSJA	84
VITI	1965
NUMRI I FAQEVE	68
LLOJI I DOKUMENTIT	Vendim
NR.	6
DATA E KRIJIMIT	25.03.1965
KOMISIONI	Beqir Balluku

ANËTARËT	Kadri Hazbiu, Bilbil Klosi, Aranit Çela, Shuap Panariti


TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

MEDIA #7

Vendim nr . 1, dt. 18.07.1976 i Komisionit të Internim-Dëbimeve

MEDIA FAQE #1



Mod. 7

Emërtimi i institucionit Ministria e Punëve të Brendshme
Emërtimi i sektorit Drejtoria e Arg. Pitkat
Dega 8

DOSJE Nr. 173 Viti 1973

TITULLI I DOSJES


Vendime të Komisionit të Internim - Dëbimeve për internimin e dëbimit e personave me gjendje të keq politik.

Afati i ruajtjes "përherë"
Fleta e fletëve 76

Ka filluar më 18.01.1973
Ka mbaruar më 10.07.1973
Regjistruar në inventarin e dosjeve me numer rendor

Vendim nr . 1, dt. 18.07.1976 i Komisionit të Internim-Dëbimeve

MEDIA FAQE #2



REPUBLIKA POPULLORE E SHQIPËRISË
KOMISIONI INTERNIM-DËBIMEVE

Sekret
Grupi II-të
Ekz.Nr. 1

Tiranë më 18.7.1973

V E N D I M Nr. 1

Komisioni i Internim-dëbimeve i mbledhur më dt. 18-7-1973 në bazë të dekretit të Presidiumit të Kuvendit Popullor Nr. 1906 datë 2.8.1954,pasi shyrtoi propozimet e paraqitura nga Ministria e P.të Brendëshme

V E N D O S I

Për arsye se nuk paraqesin rrezikëshmëri shoqërore tu heqë masën e internimit personave të poshtëshënuar:

1. [redacted]i dl.1901,me banim në Voskop të rrethit të Korçës.
2. [redacted]e dl.1903,gruaja e Demiraliut.

Janë internuar me vendim Nr. 22 datë 1.7.1969.


3. [redacted]i dl.1922,lindur dhe banuës në Korçë,internuar me vendim Nr.24 datë 23.5.1968.
4. [redacted] dl.1900,nga Korça (vdekur më 11.XII.1972).
5. [redacted]e dl.1915,gruaja e Njaziu
6. [redacted]i dl.1946

Janë internuar me vendim Nr. 22 datë 1.7.1969.

7. [redacted]e dl.1942,me banim në qytetin e Durrësit,internuar me vendim Nr. 54 datë 4.X.1972.
8. [redacted]i dl.1920,ish me banim në Tiranë,internuar me vendim Nr.28 datë 13.8.1969.
9. [redacted]i dl.1934,ish me banim në Tiranë,internuar me vendim Nr. 28 datë 13.8.1969.
10. [redacted],i dl.1919,ish me banim në

Vendim nr . 1, dt. 18.07.1976 i Komisionit të Internim-Dëbimeve

MEDIA FAQE #3



- 2 -

Tiranë,internuar me Vendim Nr. 35 datë 16.5.1972.

11. M[redacted],i dl.1936,lindur në Krujë,ish me banim në Durrës,internuar me vendim Nr.32 datë 22.9. 1971 në Vil-Boshtovë.

12. Vë[redacted],i dl.1921,ish me banim në Tiranë,internuar në Kute të Fierit me Vendim Nr.35 datë 16.5.1972.

13. F[redacted],bashkëshortja e Veliut.

14. M[redacted],ish me banim në Tiranë, internuar me Vendim Nr. 35 datë 22.9.1971 në fshatin Allgjat.

15. N[redacted],nga Dhivri,me banim në Borsh të Sarandës.

16. H[redacted]me banim në Borsh.

17. [redacted],me banim në Borsh.

18. T[redacted],me banim në Borsh.

Janë internuar në vitin 1967 dhe me vendim Nr. 28 datë 6.5.1972 janë internuar për 5 vjet të tjerë.

19. H[redacted]i dl.1944,ish me banim në Tiranë,internuar me vendim "r.9 datë 7.I.1972 në Kurjan të Fierit.

20. M[redacted],ish me banim në Tepelenë internuar në Çelenicë të Vlorës me vendim Nr.14 datë 25.2.1972.


21. S[redacted],i dl.1912,ish me banim në qytetin e Tiranës,internuar në Kafaraj të Fierit me vendim Nr. 18 datë 29.2.1972.

22. H[redacted]i dl.1949,lindur dhe banuës në Tiranë,beqar,me arsim fillor,punëtor në NTSH udhëtarëve,i pa dënuar,i internuar në katundin Vrap me vendim Nr. 35 datë 16.5.1972

23. V[redacted]e datëlindjes 1952,lindur dhe banuëse në qytetin e Tiranës,me arsim 6 klasë,e pa dënuar, e pa martuar,pa punë,e internuar në katundin Vrap të rrethit të Tiranës me vendim "r. 35 datë 16.5.1972.

Vendim nr . 1, dt. 18.07.1976 i Komisionit të Internim-Dëbimeve

MEDIA FAQE #4



- 3 -

24. Be[redacted],ish me banim në Tiranë,internuar në Patk-Milot të Durrësit me vendim Nr. 23 datë 3.7.1971.

Zv.Kryetari i Komisionit
Kadri Hazbiu

Kryetari i Komisionit
XXXXXXXXXXXXXXX

Anëtarët
Prokurori i Përgjithshëm
Dhori Panariti

Kryetari i Gjykatës Larta
Aranit Çela

Vendim nr . 1, dt. 18.07.1976 i Komisionit të Internim-Dëbimeve

INFORMACION

Vendim nr . 1, dt. 18.07.1976 i Komisionit të Internim-Dëbimeve

FONDI	4
DOSJA	123.1
NR. I FLETEVE	79
DEGA	9
LLOJI I DOKUMENTIT	Vendim
NR.	1
DATË	18.07.1973
KOMISIONI	Kadri Hazbiu
ANËTARËT	Dhori Panariti, Aranit Cela


TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

MEDIA #8

Vendimi Nr. 2 i Komisionit të Internim-Dëbimeve: Internimi i një familjeje në Amonicë të Vlorës

MEDIA FAQE #1



REPUBLIKA POPULLORE E SHQIPERISE
KOMISIONI INTERNIM-DEBIMEVE

"S e k r e t"
Grupi II-te
Eksemp.Nr.1.

Tirane, me 18.I- 1973

V E N D I M Nr. 2

Komisioni i Internim-Debimeve i mbledhur me daten 18-I- 1973, ne baze te dekretit te Presidiumit te Kuvendit Popullor Nr. 1906 date 2.8.1954, pasi shqyrtoi propozimet e paraqitura nga Ministria e Puneve te Brendshme ;


V E N D O S I

Per arsetye se jane familje me perceptje te keqe politike dhe me qe paraqesin rrezikshmeri shoqerore, te internoje per 5 vjet -kohe ne fshatin Amonice te rrethit Vlore:

1. [redacted], i date-lindjes 1900, lindur ne Sevaster, banues ne qytetin e Vlores, aresim fillor, shtrese e pasur, i martuar, pensionist.
2. [redacted] e date-lindjes 1917, lindur ne katundin Velçe, banuese ne Vlore, bashkeshortja e Medinit.
3. [redacted] i date-lindjes 1951, lindur ne Sevaster, banues ne Vlore.
4. [redacted], e date-lindjes 1953, lindur ne Tirane, banuese ne Vlore, gruaja e Fatoshit.
5. [redacted] date-lindjes 1940, lindur ne Sevaster, banues ne qytetin e Vlores.
6. [redacted] e date-lindjes 1946, lindur dhe banuese ne Vlore, bashkeshortja e Xhemalit.
7. [redacted] i date-lindjes 1939, lindur ne Sevaster banues ne Vlore.

Vendimi Nr. 2 i Komisionit të Internim-Dëbimeve: Internimi i një familjeje në Amonicë të Vlorës

MEDIA FAQE #2



2.

8. [redacted], e date-lindjes 1948, lindur ne Kute te Mallakastres, banuese ne Vlore, bashkeshortja e Sabriut.

9. [redacted], i date-lindjes 1943, lindur ne Sevaster , banues ne Vlore.

10. [redacted], e date-lindjes 1951, lindur ne Dames te Tepelenes, banuese ne Vlore,bashkeshortja e Lutfiut.

Internimi u fillon me daten 18.1.- 1973 dhe ju mbaron me daten 18.1.- 1978.

ZV.KRYETARI KOMISIONIT
/KADRI HAZBIU/

KRYETARI KOMISIONIT
[redacted]

A N T A R E T

PROKUROR PERGJITHSHEM
/ DHORI PANARITI /

KRYETARI GJYKATES LARTE
/ARANIT CELA /

AIDSSH

Vendimi Nr. 2 i Komisionit të Internim-Dëbimeve: Internimi i një familjeje në Amonicë të Vlorës

INFORMACION

Vendimi Nr. 2 i Komisionit të Internim-Dëbimeve: Internimi i një familjeje në Amonicë të Vlorës

FONDI	4
DOSJA	123.1
NUMRI I FAQEVE	79
LLOJI I DOKUMENTIT	Vendim
NR.	2
DATË	18.1.1973
KOMISIONI	Beqir Balluku
ANËTARËT	Kadri Hazbiu, Dhori Panariti, Aranit Cela


TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

MEDIA #9

Vendimi Nr. 3 i Komisionit të Internim-Dëbimeve: Internimi i familjarëve të të arratisurve në Hajmel dhe Mjedë

MEDIA FAQE #1



REPUBLIKA POPULLORE E SHQIPËRISË
KOMISIONI I INTERNIM-DEBIMEVE

"S e k r e t"
Ekzm.Nr. 1
Grupi II-të
Tiranë, më 18/1- 1973

V E N D I M Nr. 3

Komisioni i Internim-dëbimeve i mbledhur më datën 18/1- 1973 në bazë të dekretit të Presidiumit të Kuvendit Popullor Nr.1906 datë 2.8.1954 pasi shqyrtoi propozimet e paraqitura nga Ministria e Punëve të Brendëshme.

V E N D O S I:

Për arsye se u janë arratisur jashtë shtetit pjestarë të familjes dhe meqë paraqesin rrezikshmëri për tu arratisur të internohen për 5 vjet kohë:

1. M[redacted], i datlindjes 1943, lindur dhe banues në qytetin e Shkodrës, beqar, me arsim të mesëm, mekanik, shtresë e varfër, të internohet në kooperativën bujqësore të fshatit Hajmel.
2. M[redacted], e datlindjes 1908, ish punëtore, pensioniste, nëna e Lekës të internohet në kooperativën bujqësore Hajmel
3. G[redacted] i biri i Simonit, i datlindjes 1913, lindur në Lajç, me banim në Pentarë të rrethit Shkodër, bujk autodidakt, i martuar, shtresë e mesme, të internohet në kooperativën bujqësore të bashkuar të Mjedës.
4. K[redacted] e datlindjes 1925, lindur e banuese në Pentar, shtëpiake, pa arsim, bashkëshortia e Gjonit, të internohet në kooperativën bujqësore të bashkuar Mjedë.

Internimi u fillon më datën 18.1- 1973 dhe u mbaron më datën 18.1- 1978.

ZV.KRYETARI KOMISIONIT
/ KADRI HAZIU /

KRYETARI I KOMISIONIT
/ [redacted] /

A N T A R E T

PROKUROR I PËRGJITHSHËM
/DHORI PAJARTI/

KRYETARI GJYKATËS LARTË
/ARAPIN CEKA/

Vendimi Nr. 3 i Komisionit të Internim-Dëbimeve: Internimi i familjarëve të të arratisurve në Hajmel dhe Mjedë

INFORMACION

Vendimi Nr. 3 i Komisionit të Internim-Dëbimeve: Internimi i familjarëve të të arratisurve në Hajmel dhe Mjedë

FONDI	4
DOSJA	123.1
NUMRI I FAQEVE	79
LLOJI I DOKUMENTIT	Vendim
NR.	3
DATA E KRIJIMIT	18.1.1973
KOMISIONI	Beqir Balluku

ANËTARËT	Kadri Hazbiu, Aranit Cela, Dhori Panariti


TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

MEDIA #10

Vendimi Nr. 6 i Komisionit të Internim-Dëbimeve: Internimi i një personi në sektorin e N.B.SH Hoxharë të Fierit

MEDIA FAQE #1



REPUBLIKA POPULLORE E SHQIPËRISË
KOMISIONI INTERNIM-DËBIMEVE

Sekret
Grupi II-të
Ekz."r. 1

Tiranë më 18.1.- 1973

V E N D I M Nr. 6

Komisioni i Internim-dëbimeve,i mbledhur më datën 18.1.- 1973 në bazë të dekretit të Presidiumit të Kuvendit Popullor Nr.1906 datë 2.8.1954 pasi shqyrtoi propozimin e paraqitur nga Ministria e P.Brendëshme

V E N D O S I

Për arsye se mban qëndrim të keq politik dhe meqë paraqet rrezikëshmëri shoqërore të internojë për 5 vjet kohë në N.B.SH. Sektori Hoxharë të rrethit të Fierit.

1. [redacted] i dl.1949,lindur në Kor[redacted]ë,me banim në Tiranë,me arsim të mesëm,mekanik,beqar,shtresë e varfër.

Internimi i fillon më datën 17.3.- 1973 dhe i mbaron më datën 17.3.- 1978.

Zv.Kryetari i Komisionit
Kadri Hazbiu

Kryetari i Komisionit
[redacted]

Anëtarët
Prokurori Përgjithshëm
Dhori Kanariti

Kryetari i Gjykatës Larte
Aranit Çela

Vendimi Nr. 6 i Komisionit të Internim-Dëbimeve: Internimi i një personi në sektorin e N.B.SH Hoxharë të Fierit

INFORMACION

Vendimi Nr. 6 i Komisionit të Internim-Dëbimeve: Internimi i një personi në sektorin e N.B.SH Hoxharë të Fierit

FONDI	4
DOSJA	123.1
NUMRI I FAQEVE	79
LLOJI I DOKUMENTIT	Vendim
NR.	6
DATË	18.01.1973
KOMISIONI	Beqir Balluku

ANËTARËT	Kadri Hazbiu, Dhori Panariti, Aranit Cela

TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.